



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Shoqërisë «Gourmet & Co» shpk
Durrës Lagjja 3, Rruga Skenderbej, Magazine 1-Kateshe, Prapa Drejtorisë
TatimTaksa Durrës.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit e zgjedhur në bazë të Nenit 34 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) Kreu IV, neni 39 është “**Kërkesë për Propozim**”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje ujë i pijshëm për punonjësit e Bashkisë Tiranë për vitin 2018**”.

Fondi limit: 1.404.957 (një milion e katërqind e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Burimi i financimit: Të ardhura – të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së me anë të VKB Nr.132, datë 21.12.2017 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për Vitin 2018” (i ndryshuar)

Referenca e procedurës së prokurimit: **REF-74874-06-14-2018**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **28.06.2018 ora 11.00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike** Nr. 25 datë 25 Qershor 2018

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Lajthiza Invest” sha

NUIS- J98009202P

Vlera e ofertës pa TVSH është **1.260.000 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.**

2. Operatori ekonomik “Gourmet & Co” shpk

NUIS- K71923501P

Vlera e ofertës pa TVSH është **1.398.000 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. Operatori ekonomik “Lajthiza Invest” sha

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme.

Në dokumentat e tenderit Shtojca7 ”Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ”Kapaciteti ekonomik dhe financiar” (modifikuar nga autoriteti kontraktor), germa I/c është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“Vërtetim lëshuar nga Komuna ose Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR”.

Nga verifikimi në S.P.E (sistemin e prokurimeve elektronike) të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ”Lajthiza Invest” sha rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga operatori ekonomik sa më sipërcituar janë paraqitur:

1. Vërtetimi i datës 19.06.2018 me nr 290 Prot lëshuar nga Bashkia Fushe-Arrez.
2. Vërtetimi i datës 20.06.2018 me nr 158072/1 Prot lëshuar nga Bashkia Tiranë.

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin Historik të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit ”Lajthiza” shpk, në rubrikën “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit” rezulton se aktualisht kjo shoqëri ushtron aktivitet dhe është operativ në Puke, Kashar, Tirane, Durrës dhe seline qëndrore e ka ne Kukës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Lajthiza Invest” shpk nuk ndodhet në kushtet e përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Tiranës dhe Pukes; ndërkohë që nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkinë Durrës, Kukes ku ai rezulton të jetë operativ.

Ne nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Në vijim në Nenin 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikohet se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.* Në pikën 6 të këtij neni citohet gjithashtu se: “Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”.

3. Autoriteti kontraktor ne piken 2.3 (kapaciteti teknik) ka kerkuar si me poshte vijon
 - *Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër transportin e mallit objekt prokurimi pranë Bashkisë Tiranë si edhe vendosjen e tij pranë ambjenteve të Bashkisë Tiranë sipas kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor. (Deklarate nga Administratori i shoqerise).*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik konstatoi se mungon kjo deklaratë duke rënë ndesh me piken sa më sipercituar.

4. Autoriteti Kontraktor po ne piken 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim ka kerkuar si më poshte vijon:

”Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të ujit të kontratave të ujit që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

Ne vijim të shqyrtimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur vërtetimin me Nr 16014/1 dt 26.06.2018 të leshuar nga Ujesjelles Kanalizime Tiranë ku është cituar se për objektin që disponon në qytetin e Tiranës i ka likujtuar detyrimet për pagesën e ujit të pijshëm. Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit **”Lajthiza” shpk**, në rubrikën *“Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit”* rezulton se aktualisht kjo shoqëri ushtron aktivitet dhe është operativ në Puke, Kashar, Tirane, Durrës dhe seline qëndrore e ka në Kukës. Nderkohet

operatori ekonomik duhet te kishte paraqitur kete vertetim edhe per qytetet tjera sa me sipercituar ku ai eshte aktualisht operativ

Per sa me siper eshte referuar, Ju bejme me dije se oferta Juaj nuk kualifikohet ne proceduren e prokurimit me objekt: “ Blerje uje i pijshem”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“Gourmet &Co” shpk me adresë:** Adresa: Durres Lagjja 3, Rruga Skenderbej, Magazine 1-Kateshe, Prapa Drejtorise Tatim Taksa Durres, se oferta paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh **1.398.000 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedure prokurimi.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur një ankesë nga operatori ekonomik «Lajthiza Invest» sha hyre ne Bashkine e Tiranës në dt. 05.07.2018. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave i ngritur per trajtimin e këtij rasti me anë të urdhërit Nr 23259/4 dt 05.07.2018 i ka kthyer përgjigje palës ankimuese në dt 09.07.2018 (e administruar në dosjen e procedures se prokurimit»). Duke qënë se ky operator ekonomik nuk e ka ushtruar të drejtën e tij legjitime për tu ankimuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendosi të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës.